



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi i Deputetëve “Miqtë e fëmijëve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.03.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”

Rendi i ditës:

1. Miratimi i strukturës së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, bazuar në Planin Strategjik dhe të Veprimit 2016 – 2018.
2. Miratimi i përbërjes së komiteteve dhe i anëtarëve të tyre.
3. Diskutime rreth kalendarit të punës së grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”.
4. Të ndryshme.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Petrit Vasili, Eglantina Gjermani, Elisa Spiropali, Ervin Bushati, Milva Ekonomi, Nora Malaj, Elona Hoxha, Ermonela Felaj, Klotilda Bushka, Evis Kushi, Dhurata Çupi, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Rudina Hajdari, Valentina Duka, Isuf Çelaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Edlira Bode.

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Të nderuar deputetë, anëtarë të grupit “Miqtë e fëmijëve”,

Në cilësinë e kryetarit të këtij grupi, kam kënaqësinë të hap mbledhjen e radhës së grupimit “Miqtë e fëmijëve”.

Në rendin e ditës kemi miratimin e strukturës së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, bazuar në planin strategjik dhe atë të veprimit 2016 – 2018; miratimin e përbërjes së komiteteve dhe anëtarësisë së tyre; diskutimin e projektkalendarit të punës së këtij grupimi dhe propozime ose nevojë për ndryshime të dokumenteve të miratuara më parë nga grupi parlamentar “Miqtë e fëmijëve” të rregullores së brendshme të funksionimit të këtij grupi, planit strategjik dhe atij të veprimit ose planit të punës dhe të veprimit.

Para se të fillojmë me diskutimin e çështjeve që shtrova në rendin e ditës, dëshiroj të falënderoj deputetët, të cilët aktualisht janë pjesë e këtij grupi, për gatishmërinë që ata kanë treguar, gjithashtu dua t’u bëj thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit, të cilët kanë dëshirën dhe ndjeshmërinë për t’u bërë pjesë e këtij grupimi, në çdo kohë ata mund të jenë pjesë e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Duke uruar që grupit t’i bashkohen edhe deputetët e tjerë, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, që është miratimi i strukturës së grupit.

Sipas rregullores së brendshme të këtij grupimi dhe planit strategjik, struktura e grupimit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetarët, komitetet dhe anëtarët. Një listë të anëtarëve ju e keni në dosjet tuaja. Aktualisht grupimi përbëhet nga 24 deputetë, ku 20 janë anëtarë, kryetari dhe tre zëvendëskryetarët. Zëvendëskryetarët janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme dhe në planin strategjik të veprimit. Ata janë:

Kryetarja e Nënkomisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, zonja Vasilika Hysi.

Kryetari i Komisionit për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, zoti Petrit Vasili

Kryetarja e Nënkomisionit për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, zonja Eglantina Gjermeni.

Sipas përcaktimeve në rregullore dhe në planin strategjik të veprimit, grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ka në përbërje disa komitete të përbëra nga një grup deputetësh, të cilët krijohen për të ndjekur çështje që mbulojnë deputetët, në zbatim të objektivave strategjike të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”:

Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna

Komiteti për të Miturit në Konflikt me Ligjin

Komiteti për Fëmijët në Institucione Publike

Komiteti për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve

Komiteti për Marrëdhëniet me Organizatat e Shoqërisë Civile

Komiteti për Buxhetin e Fëmijëve.

A ka pyetje, sugjerime apo komente për pikën e parë të rendit të ditës?

Po, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Unë kam vetëm një sugjerim për çështjen e projektpërbërjes së strukturës në përgjithësi. Dje kam dërguar edhe një letër me shkrim lidhur me kryesinë e komisionit...

Gramoz Ruçi – E kam në pikën e katërt.

Në pikën e katërt do të diskutojmë çdo propozim që mund të ketë për strategjinë, për rregulloren apo për çështje të tjera.

Kush është dakord me strukturën e paraqitur? Dakord.

Miratohet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, në miratimin e përbërjes dhe anëtarësisë së komiteteve.

Së pari, më lejoni t'ju sqaroj se shpërndarja e deputetëve nëpër komitetet e grupimit është bërë sipas propozimeve që ju vetë keni bërë, secili prej jush është shprehur lidhur me anëtarësinë në secilin komitet. Gjithsej janë 6 komitete dhe secili nga zëvendëskryetarët drejton 2 prej tyre. Zonja Hysi drejton Komitetin për Marrëdhëniet me Organizatat e Shoqërisë Civile, ku bëjnë pjesë: zonja Milva Ekonomi, zonja Kejdi Mehmetaj, zonja Vilma Bello dhe zoti Endri Hasa, si dhe Komitetin për të Miturit në Konflikt me Ligjin, i cili përbëhet nga: Oerd Bylykbashi, Dhurata Çupi (Tyli) dhe Klotilda Bushka.

Zoti Vasili do të drejtojë Komitetin për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve, i cili përbëhet nga zoti Halim Kosova, zonja Dhurata Çupi (Tyli), zonja Elisa Spiropali dhe zonja Elona Hoxha, si dhe Komitetin për fëmijët në institucione publike, i cili ka në përbërje zonjën Valentina Duka, zonjën Kejdi Mehmetaj, zonjën Izmira Ulqinaku dhe zotin Bledi Çuçi.

Zonja Gjermani do të drejtojë Komitetin për Buxhetin e Fëmijëve, i cili përbëhet nga zonja Ermonela Valikaj (Felaj), zoti Isuf Çela dhe zonja Evis Kushi, si dhe Komitetin për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, i cili përbëhet nga zonja Albana Vokshi, zonja Nora Malaj, zoti Ervin Bushati, zonja Rudina Hajdari dhe zonja Elona Hoxha (Gjebrea).

A ka pyetje, komente apo sugjerime për përbërjen e komiteteve?

Vasilika Hysi – Faleminderit, Kryetar!

Te Komiteti për Buxhetin e Fëmijëve, ka shprehur dëshirën dhe në organigramë është edhe Milva Ekonomi. Ndërkohë, të pranishëm ka edhe deputetë dhe deputete që kanë qenë pjesë e grupimit “Miqtë për fëmijët” në legjislaturën e kaluar dhe që kanë dëshirë të jenë në një nga këto komitete.

Dhurata Çupi- Faleminderit, Kryetar!

Unë propozoj edhe deputeten e Partisë Demokratike, përfaqësuese e qarkut Vlorë, Nada Meçorapaj, që të jetë pjesë e këtyre komiteteve, por, gjithashtu, të jetë pjesë e grupit “Miqtë e fëmijëve”, sepse nuk është.

Gramoz Ruçi – Edhe një herë emrin.

Dhurata Çupi – Nada Meçorapaj.

Vasilika Hysi – Nadire.

Dhurata Çupi – Faleminderit!

Blerina Gjylameti- Unë jam njëra nga deputetet që kam qenë te grupi dhe përsëri do t'i bashkëngjitem grupit “Miqtë e fëmijëve” dhe do të doja të isha pjesë e Komitetit për Buxhetin e Fëmijëve. Bashkë me mua janë edhe dy kolege të tjera, të cilat mund të shprehin vetë se ku kanë dëshirë të jenë pjesë.

Faleminderit!

Edlira Bode – Ju përsërisht!

Nuk kam nënshkruar akoma formularin për të qenë anëtare, por do të doja të isha pjesë e Komitetit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve dhe, nëse është e mundur pjesëmarrja në dy komitete, do të doja të isha pjesë e Komitetit për Fëmijët në Institucionet Publike.

Faleminderit!

Antoneta Dhima– Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë i bashkëngjitem këtij grupimi dhe dua të jem pjesë te Komiteti i Buxhetit për Fëmijët, si pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe njëkohësisht si pjesë e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, si rregull, një anëtar i grupimit mund të marrë pjesë në një ose në dy komitete, jo më shumë.

Gramoz Ruçi – A jeni dakord që zonja Edlira Bode të jetë pjesë e Komitetit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve dhe Komitetit për Fëmijët në Institucionet Publike?

Ju lutem më ndihmoni me propozimet për te Komiteti për Buxhetin.

Vasilika Hysi – Janë Blerina Gjylameti dhe Antoneta Dhima.

Gramoz Ruçi – Domethënë u propozuan Milva, Blerina dhe Antoneta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Nuk ka raporte kjo. Vetëm partitë mos na i fut këtu të lutem!

Mund të shkojë ku të dojë, por jo për shkak të raportit.

Gramoz Ruçi- A jeni dakord? Dakord.

Vasilika Hysi – Edhe zonja Nadire Meçorapaj te Komiteti i Buxhetit.

Gramoz Ruçi – Po ashtu edhe te Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna.

Nora Malaj – Unë dua të bëj dy propozime. Ne propozuam të kishim vetëm një mundësi anëtarësimi, jo dy dhe, meqenëse është në dy, unë personalisht propozoj të jem anëtare te Komisionit për të Miturit në Konflikt me Ligjin.

Ndërkohë, më lejoni të bëj propozimet për disa nga koleget që sot nuk janë këtu, por që do të kishin dëshirë të ishin, ndoshta jo në këtë moment, por pak më vonë, pasi do të ishte mirë që i gjithë ky komision për ata që kanë interes, por që nuk e kanë e njohur problematikën ose nuk e kanë shumë të qartë, t'i japim mundësinë që deri nesër të sjellin propozimet e tjera.

Gramoz Ruçi – S'ka asgjë, janë të mirëpritur. Kushdo që aspiron për t'u bërë pjesë e grupit është i mirëpritur, sigurisht ndarja bëhet nëpër komitete.

A jeni dakord që zonja Malaj të jetë në Komitetin për të Miturit dhe Konfliktin me Ligjin? Dakord.

Pika e tretë e rendit të ditës është diskutimi i projektkalendarit të veprimtarive që do të zhvillojë grupi i deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Ky projektkalendar është hartuar për periudhën mars-korrik 2018, pra deri në përfundim të sesionit parlamentar. Në dosjet tuaja keni kopje të projektkalendarit. A ka pyetje apo vërejtje lidhur me kalendarin e veprimtarive?

Vasilika Hysi – Mund të them diçka?

Gramoz Ruçi - Po.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Ky kalendar është një projekt, që do të thotë se me miratimin e tij ai do të kthehet në një kalendar pune, por ne propozojmë, edhe në kuadër të komisioneve parlamentare, ku ne jemi të angazhuar, të ftojmë të gjithë grupin “Miqtë e fëmijëve” për të qenë pjesë e aktiviteteve, veprimtarive dhe diskutimeve të ligjeve, projektligjeve ose rezolutave që kanë lidhje me të drejtat e fëmijëve. Ato lloj aktiviteteve që mund të lindin në kuadër të planifikimit që bëjmë në kalendarët e komisioneve dhe nënkomisioneve nuk janë përfshirë të gjitha këtu. Megjithatë, ne mund të bëjmë edhe një rishikim, pasi kemi biseduar me UNICEF-in për të bërë rishikimin e planit të veprimit dhe rregullores, e cila është e vakët, sepse ishte si fillim dhe ishte shumë

modest, por tani që shohim se ka një angazhim serioz nga të gjithë deputetët e kësaj legjislature, do ta bëjmë më të plotë dhe më zyrtar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Unë propozoj që komitetet nën drejtimin e zëvendëskryetarëve të mblidhen pas kësaj mbledhjeje, të konstituohen si të tillë dhe të kishin akses, besoj se e gjejmë gjuhën e përbashkët dhe biem dakord, që komitetet të ishin ata që përcaktojnë kalendarin në varësi të natyrës që kanë. Unë shoh kalendarin dhe Komiteti për Buxhetin ka vetëm një aktivitet, që për mendimin tim nuk qëndron, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këtë po them, është mirë që komitetet të mblidhen, të konstituohen si të tilla nën drejtimin e zëvendëskryetarëve, sipas ndarjes që ju keni propozuar dhe, me këtë rast të bëjnë propozimet përkatëse për kalendarin e punës. Pra, të kemi liri në përcaktimin e kalendarit, kjo është ideja.

Gramoz Ruçi – Në parim jemi dakord, pastaj për shtesat varen edhe nga... sepse ka një problem, që në qoftë se do ta lëmë që të mblidhen të gjitha komitetet, do të shtyhen me disa ditë, me muaj dhe pastaj...

Klotilda Bushka- Në fakt, në vijim të asaj që tha zonja Felaj, është e rëndësishme që secili komitet të ketë kalendarin e vet, që në projektin që kemi para është i parashikuar në pikën 4, “Hartimi dhe miratimi i kalendarit të punës nga secili komitet”. kështu që në parim është e përfshirë, pastaj mund ta detajojë secili komitet.

Gramoz Ruçi- Dakord.

Nora Malaj – Sigurisht, kalendari është parë duke u nisur nga parimet kryesore dhe nga aktivitetet kryesore që ne do të realizojmë, por unë dua që në fleksibilitetin e kalendarit të futeshin disa probleme që kemi sot dhe që mund të jenë shumë sensitive. Për shembull, një nga problematikat më sensitive që ka sot shoqëria lidhet me elementin e bulizmit dhe do të ishte mirë që të bëhej një dëgjese ose aktivitet, ku parlamenti mund ta shikonte edhe në kaudër të hartimit të disa projektligjeve dhe ideve.

Gramoz Ruçi – Dakord. Të formulohet dhe të futet në rendin e mbledhjes së ardhshme.

Atëherë e mbyllim këtë çështje dhe kalojmë në pikën e fundit. Siç e thashë në fillim të fjalës sime, për miratimin e rendit të ditës, duke përshëndetur legjislaturën e kaluar, që krijoi mundësinë e ngritjes së këtij grupi deputetësh “Miq të fëmijëve”, si dhe miratoi disa dokumente për organizimin e tij, siç janë:

1. Rregullorja e brendshme, që është miratuar në mars të vitit 2016;
2. plani strategjik dhe i veprimit për periudhën 2016 – 2018;

3. plani i punës së veprimit 2016-2018.

Sigurisht, të tria këto dokumente janë në fuqi edhe sot që ne jemi mbledhur, por për shkak të kohës, sepse tashmë ka kaluar dy vjet nga miratimi i tyre, besoj se është e nevojshme që të ketë përmirësime dhe ndryshime për veprimtarinë e grupit, që të përditësohen. Kështu që t'i diskutojmë, qoftë sot, qoftë një herë tjetër. Ashtu siç e patë, zoti Vasili, ka bërë një propozim dhe e ka institucionalizuar me shkrim këtë çështje, por meqë është këtu zoti Vasili ta prezantojë vetë. Po ashtu të gjithë pjesëtarët, mund të kenë propozime të ndryshme.

Urdhëroni, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Kryetar!

Propozimi im lidhet, pikërisht, me atë që ju me të drejtë thatë, se ka pasur një dinamikë, sepse, sigurisht 2 vjet kanë dinamikën e tyre parlamentare. Lidhur me sa më sipër, propozimi im është konkret dhe ka të bëjë me kryesinë e këtij komisioni. Në rregullore kjo strukturë ka qenë e bazuar në drejtim nga Kryetari dhe nga 3 zëvendëskryetarë, ku prej tyre njëri drejton Nënkomisionin për të Drejtat Njeriut, tjetri ka qenë për Komisionin e Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe i treti ka qenë nënkomisioni për Çështjen e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje. Pra, kjo ka qenë në Rregulloren që kishim. Duke u nisur nga kjo Rregullore që kemi, sigurisht, kjo ka nevojë për reflektim, pasi Nënkomisioni për Çështjen e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje nuk ekziston më. Me vendim unanimit nga parlamenti është ndërtuar një Nënkomision tjetër, që është Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, i cili ka një objekt shumë të qartë në punën e tij, të përcaktuar në dokumentin parlamentar, që ka të bëjë me: “Monitorimin e politikave qeveritare në mbështetje të gruas, familjes; synimi i zhvillimit ekonomik-social në harmoni me mirëqenien e individëve; realitetet e reja në tregun e punës; përmirësimi dhe respektimi i të drejtave të gruas dhe fëmijëve dhe sfidat e jetës së përditshme”.

Së pari, nënkomisioni është rikompozuar, sepse edhe çështjet e dhunës në familje dhe barazia gjinore kanë pasur një specifikë të caktuar. Këtu duhet një reflektim, pasi objekti i këtij nënkomisionit del shumë jashtë objektivave që është ndërtuar.

Së dyti, kam një propozim konkret: në sekretarinë e komisionit në pozicionin e zëvendëskryetares të jetë edhe kryetarja e Komisionit për Edukimin Medien dhe Mjetet e Informimit, pasi objekt i madh i punës së këtij komisioni është edhe edukimi, ku mosha fëmijënore nga të gjitha strukturat e saj, parashkolllore, shkollore e të tjerë, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të, sikurse lidhet edhe shëndetësia, pasi kjo është edhe psikologjia, mentaliteti dhe filozofia e këtij komisioni. Të gjithë aktorët, të cilët janë aktivë flasim për instrumentet parlamentare në këtë drejtim, minimalisht duhet të kenë përfaqësimin. Në rastin konkret, unë

propozoj që kryetari i Komisionit për Edukimin, Medien dhe Informimin Publik të jetë në pozicionin e të këtij grupimi. Në radhë të parë dhe mbi të gjitha për shkak të objektit të punës për të cilën, në mënyrë konkrete, ky komision merret, që është i pamohueshëm, është një nga elementet thelbësore të jetës, të mirërritjes, të shëndetit psikologjik dhe mendor dhe të shumë elementeve të tjera, që lidhen me fëmijët.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ka propozim tjetër?

Dhurata Çupi – Faleminderit!

Pa e ditur propozimin e zotit Vasili, paraprkisht ia komunikova zonjës Hysi, e cila tha se jemi në vazhdimësi për ndryshimin e rregullores së brendshme, ku do ta shikojmë edhe këtë çështje, duke përfshirë edhe futjen e kryetarit që drejton Komisionin për Medien dhe Informimin Publik. Kështu që, në qoftë se vendoset, ne do të jemi dakord me propozimin e zotit Vasili.

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqenëse çështjet e të miturve nuk janë më objekt i një nënkomisioni, sugjeroj krijimin e një nënkomisioni vetëm për çështjen e të miturve, duke qenë se Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës në Familje që është krijuar, është krijuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi e miratuam së bashku me unanimitet rezolutën kundër dhunës ndaj gruas. Kështu që, në këto kushte, nuk kemi një nënkomsion të mirëfilltë, që merret me çështjet e të miturve, që mendoj se i duhet këtij parlamenti, përveç “Miqve të fëmijëve”, që jemi ne këtu, mendoj edhe për nisma ligjor dhe çfarëdolloj problematike tjetër, për të na ndihmuar dhe për t’i koordinuar më mirë punët bashkë. Shumë mirë, kryetari apo kryetarja e nënkomisionit për të mitur, mund të vijë në këtë vend dhe unë mund të vazhdoj si anëtare e thjeshtë të Grupi “Miqte e fëmijëve”, jo si nënkryetare.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, kam një sugjerim, së pari, ne duhet të vendosim në këtë mbledhje pa vonuar, sepse kemi humbur relativisht një kohë të gjatë, se kush do të fillojë kryesimin e grupit, sipas rregullores është me rotacion, pra çdo 4-6 muaj e merr drejtimin një nga nënkryetarët. Ka jashtëzakonisht punë për të bërë. Pra, nuk është thjesht që të jemi të pranishëm këtu dhe 2-3 vetë të punojnë, kryesia të punojë, dhe të tjetër të mos punojnë, sepse në rregulloren e këtij grupimi komiteti ka një mbledhje çdo 3 muaj. Njëkohësisht, kryesia, ashtu si me të drejtë e tha

zonja Felaj, do të koordinojë punën, do të bëjë një kalendar të aktiviteteve, do të konstituohen komitetet, por ka goxha aktivitete për të bërë, nëse këtë grupim të “Miqve të fëmijëve” ta kemi një promotor të mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave të fëmijëve.

Së dyti, të nderuar kolegë, plani i veprimit është bërë para 3 vjetësh dhe sot po të shikoni, ka shumë pjesë të planit të veprimit që janë realizuar. Pra, Kuvendi ka avancuar shumë më shpejt nga ç’pritej. Për planin e veprimit, do të sugjeroja ngritjen e grupit të punës, i cili, bazuar në mendimet dhe sugjerimet e çdo anëtari të këtij grupimi, të japë mendime dhe sugjerime për ta përmirësuar planin e veprimit dhe në mbledhjen më të afërt, bashkë me propozimet për ndryshime në rregulloren e këtij grupimi, të bëjmë përmirësimet dhe përditësimin e planit të veprimit, me qëllim që t’u përgjigjemi nevojave dhe kërkesave aktuale.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Ne e kemi të trashëguar nga rregullorja, edhe disa përcaktime që janë të vjetra, sepse në rregullore është thënë: “Drejtimi dhe koordinimi të rregullohen me rotacion”. Tani ne të gjithë e kuptojmë se drejtimi dhe koordinimi rregullohen me rotacion. Por ka qenë si ka qenë, kështu nuk thuhet.

Unë mendoj se i gjithë grupi është strukturuar në mënyrë shumë korrekte, me Kryetarin dhe me të gjithë fushat e veprimtarisë. Tani, ne me rotacion të marrim drejtimin e koordinimit, kjo nuk shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne duhet ta shikojmë këtë pikë, sepse kjo pikë nuk thotë asgjë. Për mua kjo pikë as nuk duhet diskutuar, sepse ky grupim ka një drejtim të padiskutueshëm dhe drejtohet nga Kryetari dhe nënkryetarët, të cilët kanë marrë edhe punët e tyre dhe sipas nevojave mund të thërrasin mbledhjet, mund të jenë të shpejta apo mund të jenë të rralla, kjo është në respekt të problematikës dhe të Kryetarit. Mendoj se jemi në një strukturë korrekte dhe solide. Kurse kjo tjetra, nuk na thotë asgjë.

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Në kuadër të problematikave që ngrihen, por edhe të përditësimin të të gjithë planit të veprimit, po ashtu edhe të rregullores, mendoj se duhet të ngremë një grup pune, që të rishikojë rregulloren dhe propozimet e ndryshme që kanë të gjithë kolegët, nga ana tjetër, edhe për planin e veprimit. Kështu që, besoj se për të dalë edhe nga kjo, propozim pas propozimi, më mirë të ngremë një grup pune, ku të rishikohet e gjithë rregullorja dhe plani i veprimit.

Faleminderit!

Nora Malaj - Në mënyrë metodologjike, realisht, me konstituimin e grupimit, me Kryesinë e Kryetarit e Kuvendit, që është edhe personi honorifik dhe tre nënkryetarët, mendoj se secili nga ne e ka shumë të qartë të gjithë mekanizmin, sepse po të hyjmë dhe të krijojmë grupet e punës, të rishikojmë edhe një herë, mendoj se do të na duhet shumë kohë. Konkretisht, do të propozoja, duke e mbështetur dhe propozimin e zotit Vasili, secili nga grupet të marr përgjegjësinë, prandaj janë edhe nënkryetarët, nuk do ta quaja me rotacion, pasi të gjithë kemi të drejtën, nëpërmjet e Rregullores që të japim propozimet tona, pasi puna është në grup.

Në fakt, nënkryetarët apo Kryetari merr përgjegjësinë honorifike, por puna është e secilit prej nesh, sepse e zgjodhën në mënyrë vullnetare. Do të propozoja që secili nga nënkryetarët të bëjë planin e kalendarit të punëve, duke respektuar edhe kalendarin aktual, duke mbajtur edhe propozimin e zonjës Gjermani. Mendoj se me nevojën që kemi për ndryshimet e bazës ligjore, është shumë e rëndësishme, sidomos për fëmijët, sepse kemi shumë *gap-e* në këtë gjë, pra të vijojmë nga puna duke vazhduar në këtë propozim.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Urdhëroni!

Petrit Vasili – Në logjikën e ndërtimit të grupit, për vetë përbërjen që ka, dhe strukturën nënkomisone, ne nuk kemi asnjë arsye të mbajmë në rregullore, sepse këto janë sugjerime që mund të reflektohen. Në konceptin që Kryetari ka rol honorifik, Kryetari nuk ka rol honorifik, ka rolin e drejtimit të këtij komisioni, frekuenca se si mblidhet, dinamika është një çështje që e rregullon koha. Në Rregullore është parashikuar që Kryetari do të raportojë një herë në vit në Kuvend, nuk referojnë në Kuvend kryetarët honorifikë. Kryetari drejton këtë strukturë, sigurisht Kryetari nuk do të ketë ngarkesën e përditshme, që mund të kenë nënkryetarët. Në momentin që bien dakord se do të mblidhen, Kryetari është Kryetar. Kështu që mua më duket një përcaktim pa vend dhe nuk i përshtatet kësaj mënyre si ne funksionojmë më së mirë, siç funksionon ky grup. Me thënë të drejtën, në themelin e saj Rregullorja është e qëndrueshme, nuk është se ka nevojë për rishikime thelbësore, por disa përmirësime të domosdoshme që koha i solli, mund t'i bëjmë pa humbur kohë fare. Këto gjëra mund të zgjasin edhe për një gjysmë dite apo për dy orë gjë. Po të biem dakord e bëjmë draftin përfundimtar, sepse besoj se kemi konsensualitet të plotë dhe i japim shpejtësi punës, në qoftë se duhet ta vëmë në punë këtë instrument.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Atëherë jemi dakord me propozimin e zotit Vasili. Të tre nënkryetarët: zotin Vasili, zonja Hysi dhe zonja Gjermani të ulen, dhe mbi bazë të këtyre propozimeve që u bën, të

shikojnë planin e veprimit, rregulloren dhe ndonjë dokument tjetër, që ka grupimi. Besoj se të gjithë ju jeni të hapur, që përveç propozimit që u bë këtu të bëni propozime të tjera. Sigurisht, pasi ta draftojnë, do të ma sjellin mua që ta shikoj dhe më pas t'iu shpërndalet të gjithë grupit.

Në rregull. A keni ndonjë gjë tjetër?

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Në kalendar është planifikuar data 2 prill, që është Dita Botërore e Autizimit. Ka edhe një qendër shtetërore që i trajton të gjithë këta fëmijë. Është sugjeruar edhe në kalendar dhe ne ramë dakord që të bëhet një vizitë atje.

Zoti Vasili, më duket se në datën 3 prill do të organizohet një seancë dëgjimore dhe besoj se jemi të gjithë të ftuar që ta ndjekim. Do të ishte një gjë shumë e mirë që, në adresimin e këtyre çështjeve, të kemi parasysh edhe çështjet që janë në kalendar.

Petrit Vasili – Ne e kemi fiksuar në datën 3, meqenëse 2 prilli është pushim, sepse transferohet dita e pushimit për shkak të Pashkëve katolike. Janë ftuar të gjithë ata që operojnë në fushën e autizimit. Ne kemi kërkuar edhe disa struktura që janë në nivel lokal, sepse janë me interes, sepse autizimi këtë problem ka, kapilaritetin e tij. Në këtë seancë dëgjimore të hapur është mirë që anëtarët e grupit “Miqte e fëmijëve” të jenë të pranishëm, se do të ishin dimension i shtuar për këtë gjë, që të kuptojnë se kjo problematikë, për sa i takon peshës që ka nga pikëpamja mjekësore-shoqërore, është shumë delikate. Pra, mund të themi se ky është një aktivitet i përbashkët midis Komisionit të Çështjeve Sociale dhe grupit “Miqte e fëmijëve”. Aty janë të ftuar edhe drejtoresha e qendrës që ju përmendët, por edhe të gjitha strukturat e tjera që operojnë në fushën e autizmit.

Gramoz Ruçi – Atëherë, a jeni dakord?

Elona Hoxha – Zoti Kryetar, nisur nga kjo që u tha për Ditën Botërore të Autizimit, do të ishte mirë që ne të hartojmë një kalendar me të gjitha ditët ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me fëmijët, që ne t'i dimë përpara me qëllim që të organizohemi, pra ta kemi edhe axhendën më të lirë, sepse në këtë mënyrë përgatisim edhe aktivitetet.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Shumë e drejtë. A ka njeri tjetër? Nuk ka.

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, e mbylлим. Ju lutem rregullimet, mos i shtyni në kalendrat greke, mundësisht të bëhen brenda javës, me qëllim që edhe propozimet që u bënë këtu, por edhe propozime të tjera që mund të kenë koleget dhe kolegët të përfshihen në Rregullore dhe në mbledhjen e radhës, të cilën do ta njoftojmë, t'i konkretizojmë.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA